

S T A T U T I
I SHOQËRISË TREGTARE
"DAGE PERDE" SH.P.K

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare "DAGE PERDE" SH.P.K

(shoqeri me perjegjesi te kufizuar) rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve, funksionimin dhe kompetencat e organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin NR. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare

NENI 1
Objekti i veprimtarisë

1.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijojnë më poshtë:

- a) Tregti me shumice dhe pakice,import-eksport i mallrave dhe materialeve te ndryshme si:
Perdhe dhe tekstile te te gjitha llojeve,mobilje,ene guzhine,mallra te te gjithsa llojeve per arredimin e brendshem dhe te jashtem te banesave dhe hoteleve apo institucioneve te ndryshme shteterore dhe private,tekstile,veshnabathje,industriale,bujqesore,blegtorale,mekanike,ndertimi,ushqimore,lende te para per te gjitha industrite e produkteve ushqimore apo industriale,pajisje elektro shtepiake,elektronike,vegla pune,produkte te ndryshme kozmetike,bizhuteri,shitblerjen e tyre brenda dhe jashte vendit.
- b) Ushtrimin e aktivitetit ne fushen e hoteleri turizem,bar kafe,fshat turistik,qendra argetimi,supermarkete,investimin dhe kryerjen e ketyre shebimeve ne keto sektore pune,kryerjen e sherbimeve publike .

1.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 2
Emri dhe selia e Shoqërisë

2.1 Shoqëria "DAGE PERDE" SH.P.K është Person Juridik Privat.

Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj "**DAGE PERDE**" SH.P.K (shoqeri me perjegjesi te kufizuar).

2.2 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Qendra tregtare Prestige Home,Zona kadastrale 1751,Gjokaj,Vore, Tiranë, Shqiperi.

NENI 3



Kohëzgjatja e Shoqërisë

3.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.

NENI 4 Regjimi Juridik i Shoqërisë

4.1 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtronhet dispozitave të Statutit, si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të janë në fuqi, si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

4.2 Shoqëria gjëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

NENI 5

5.1 Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetersohen, të jepen me qira, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në këtë rast vendimmarrja duhet të jetë unanime nga të gjithë ortakët pjesëmarrës me 100 % të kapitalit.

NENI 6 Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

6.1 Ortakët japid kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut dhe në marrëveshjen e posaçme të lidhur midis tyre, në të cilën është përcaktuar në mënyrë të detajuar kontributi i secilit dhe mënyra e afatit e derdhjes së këtij kontributi në këtë shoqëri. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare përdëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse. Ortakët mbajnë përgjegjësi përmes humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

6.2 Personat përgjegjës përmes administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët përmes ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet përmes gjendjen e ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

6.3 Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakët për periudha njëmuore dhe tremujore për ecurinë e shoqërisë, realizimin e objektivave mujore dhe tremujore, llogaritë, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare me partnerët nënkontraktorë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

6.4 Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të heqin dorë nga Shoqëria dhe mund të shesin kuotën e tyre në kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kushtet që i lejon Statuti dhe Ligji. Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që kanë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk i cenon ata në marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

6.5 Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjera. Ata gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Statuti. Ata përpilen për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 7 **Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë**

7.1 Ortakët e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbrushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

NENI 8

8.1 Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

NENI 9

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 lekë.

- a. Z.Dardan Kastrati** zotëron një kuotë me vlerë 100.000 lekë (Njeqind mijë lekë), që përfaqëson 100 % (njeqind %) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.



9.2 Ortakët, në bazë të kërkesës së organit administruar, mund të sjellin para në shoqëri, sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesëtueshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

9.3 Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

NENI 10 Pasuria e Shoqërisë

10.1 Shoqëria bëhet pronare e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme kur vlera e pasurisë mbulohet tërësisht në të holla.

NENI 11 Vdekja e Ortakëve

11.1 Kuotat e Ortakëve mund të transferohen lirisht tek trashëgimtarët ligjorë e testamentarë të tyre mbas vdekjes. Ortakët e mbetur mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në rast shitje të të njëjtave si pasojë e mungesës së vullnetit të trashëgimtarëve për të hyrë në vendin e të vdekurit.

Subjektet që përfitojnë nga ky transferim detyrohen të disponojnë kapitalin e transferuar për një vit në Shoqëri, duke pasur të gjitha të drejtat e mbajtësit të tij të mëparshëm. Në rast se pas vdekjes, trashëgimtarët e të ndjerit janë më shumë se një, ata duhet të emërojnë një përsaqësues të përbashkët

NENI 12 Transferimi i kuotave mes të gjallëve

12.1 Ortakët kanë të drejtën të transferojnë lirisht kuotën që zotërojnë në kapitalin e regjistruar të shoqërisë, mes të gjallëve kundrejt pagesës së një shume; gjithsesi, ortakëve të tjerë i përket e drejta e parablerjes së kuotës së kapitalit të Ortakut shitës, në rast shitje - blerjeje të saj.

12.2 Për të respektuar të drejtën e parablerjes të Ortakëve të tjerë, Ortaku që ka ndërmend të shesë, tërësisht apo pjesërisht kuotën e tij të kapitalit të regjistruar, duhet të komunikojë qëllimin e tij, të dhënët e blerësit, çmimin, mënyrat e pagesës dhe kushtet e transferimit përmes letrës rekomande, drejtuar Ortakëve të tjerë dhe secilit prej administratorëve të Shoqërisë. Ortakët, 30 ditë pas marrjes së lajmërimit (të saktësuar në fletëmarrjen postare), mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, me të njëjtat kushte siç u është komunikuar, gjithmonë përmes letrës rekomande drejtuar Ortakut që shpreh dëshirën për shitjen e kuotës. E drejta e parablerjes duhet ushtruar për të gjithë kuotën në fjalë.

12.3 Pasi të kenë kaluar 30 ditë nga njoftimi dhe asnjëri nga ortakët nuk ka ushtruar të drejtën e parablerjes së kuotës së kapitalit, Ortaku shitës është i lirë t'ia transferojet palëve të treta kuotën e tij, me të njëjtat kushte që ua kishte ofruar ortakëve të tjerë të shoqërisë.



12.4 Nëse më shumë se një nga Ortakët shpreh dëshirën të ushtrojnë të drejtën e parablerjes së kuotës së kapitalit në shitje, kuota do të ndahet në mënyrë të përpjesshme me kuotat e tyre ekzistuese.

12.5 E drejta e parablerjes përjashtohet në rast të transferimit të kuotës në favor të Ortakëve të tjérë, të bashkëshortit apo të familjarëve në vijë të parë, në çdo shkallë, apo në favor të shoqërive kontrolluese, të kontrolluara, të lidhura apo që i përkasin të njëjtë grup të shoqërisë ortake që do të transferojë kuotën.

12.6 Kuotat e kapitalit mund të transferohen në mënyrë të lirë përmes dhurimit apo çdo akti tjetër, falas.

NENI 13 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

13.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke u vendosur rritja e vlerës së kuotës së Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën, Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

NENI 14 Fondet rezervë

14.1 Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj.


NENI 15 Bilanci

15.1 Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 16 Plani finanziar

16.1 Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.



Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 17
Shpërndarja e fitimeve, kufizimi i shpërndarjes

17.1E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatifitët dhe taksat, nga kuotat që rritin kreditin për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

- a. Pas përbushjes së kërkeseve të artikullit 77 të ligjit nr. 9901, shoqëria, nëpërmjet votimit unanim të ortakëve në Asamblënë e Përgjithshme, mund të vendosë për shpërndarjen e te ardhurave në linjë me të drejtat përkatëse të secilit ortak.
- b. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
- c. Pagesa ose përdorimi i të gjitha fitimeve të mundshme, do të jenë objekt i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- d. Asnjë pagesë në monedhë, i lidhur me një kuotë të caktuar, mund të jetë mbartës interesash ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat përkatëse të kuotës në fjalë.
- e. Transferim i të ardhurave ndaj kapitalit shoqëror: administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë unanimë të votave, dhe duke pasur parasysh kushtet e artikullit 14 të ligjit nr. 9901, mund të vendosin t'i transferojnë kapitalit të shoqërisë të ardhurat e ndara, që nuk do përdoren për pagimin e dividendëve preferencialë apo shumave të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

17.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b. shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

17.3 Shoqëria do të llogarisë fitimin, do t'ia shpërndajë atë ortakëve sipas pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e shoqërisë dhe sipas marrëveshjes së posaçme të hartuar midis tyre.

IV. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 18
Asambleja e Përgjithshme

18.1 Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të

Autorizuar;

- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare mujore, tremujore e vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përcakton tagret e përfaqësimit të administratorëve në kushtet e nënshkrimit të kontratave të bashkëpunimit me shoqëri apo individë, kontratave të sipërmarrjes apo të shitjes, si dhe miraton kontratat tip që do të nënshkruhen.
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 19

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

19.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Konstatohet se ortakët që kanë pasur detyrime ndaj shoqërisë nuk i kanë realizuar ato sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- në çdo rast tjetër që e kërkojnë ortakët që zoterojnë të paktën 10 % të kuotave të kapitalit.

Ortakët vendosin mbi temat që ligji dhe statuti i japidin të drejtën të vendosin

19.2 Vendimet e ortakëve mund të merren nëpërmjet:

- a. vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme në mbledhje të zakonshme;
- b. këshillimit me shkrim

19.3 Procedura për marrjen e vendimit nëpërmjet këshillimit të shkruar, rregullohet si në vijim:

a. Njëri nga ortakët apo administratorët u komunikon të gjithë Ortakëve dhe të gjithë Administratorëve që nuk janë ortakë, tekstin e vendimit që propozohet të merret, duke fiksuar një afat jo më të shkurtër se 5 ditë, brenda të cilit secili prej Ortakëve mund t'i komunikojë shoqërisë miratimin, abstenimin apo votën kundër. Në rast se afati i caktuar është plotësuar dhe Ortaku nuk është shprehur, miratimi konsiderohet se nuk është dhënë.

b. Nga dokumentet duhet të duken me qartësi argumentet qe janë objekt i vendimit dhe miratimi i tyre.

c. Komunikimet e parashikuara nga artikujt e mësipërm a) dhe b) mund të bëhen nëpërmjet çdo mjeti dhe/ose sistemi komunikimi që lejon një provë të nisjes dhe të marrjes së komunikimit, duke përfshirë këtu faksin dhe postën elektronike. Në rastet e fundit, transmetimet ndaj Ortakëve duhen bërë në numrin e faksit dhe/ose adresën e postës elektronike që janë komunikuar në mënyrë të qartë nga vetë Ortakët.

d. Vendimi i Ortakëve, i bërë në përputhje me artikullin në fjalë, duhet të shkruhet pa asnje lloj dyshimi, nga organi administrues në librin e vendimeve të Ortakëve.

19.4 Vendimet e ortakëve merren nëpërmjet vendimeve të Asamblesë, duke respektuar mënyrën e vendimmarrjes.

19.5 Në linjë me të drejtat apo limitet që rrjedhin nga mbajtja e kuotave, secila kuotë i jep ortakut të pranishëm ose përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut i cili është i pranishëm dhe mban një autorizim legal apo që i jepet nëpërmjet ligjit, të drejtën e një vote (në rast se ai është person fizik apo shoqëri). (Ky shënim do vendoset në mënyrë më të detajuar në momentin e firmosjes së akteve parashoqërore).

NENI 20 **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

20.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vandin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

20.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet nëpërmjet video konferencës me pjesëmarrësit që mund të ndodhen në vende të ndryshme, të afërtë apo të largëta, të lidhur mes tyre në mënyrë audio/video, me kushtin që të jenë respektuar mënyra unanime dhe principi i vullnetit të mirë dhe trajtimit të barabartë mes ortakëve. Në mënyrë të veçantë, është e nevojshme qe të lejohet verifikimi i identitetit dhe të drejtës së pjesëmarrësve, të konstatohen dhe të shpalllen vendimet e mbledhjes.

Mbledhjet e shoqërisë mund të mbahen dhe jashtë selisë së shoqërisë.

20.3 Çdo Ortak, që ka të drejtën të marrë pjesë në Asamble, mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një person tjetër nëpërmjet një autorizimi të lëshuar në përputhje me ligjin.

NENI 21
Kuorumi i nevojshëm dhe marrja e vendimeve

21.1 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund te marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

21.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të jetë e vlefshme vetëm nëse marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote që përfaqësojnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

21.3 Asambleja e Përgjithshme të gjitha vendimet i merr nëpërmjet votimit të të gjithë ortakëve me të drejtë vote që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 22
Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë

22.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të registrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 23

23.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

23.2 Mund të emërohen si administratorë të shoqërisë edhe personat fizikë që nuk janë Ortakë.

23.3 Emërimi i Administratorëve bëhet me unanimitet nga Asambleja e Ortakëve.

NENI 24



Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

24.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin "Për regjistrimin e biznesit";
- g. raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h. të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- i. të bëjnë pagesa pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme vetëm për likuidimin e pagave, sigurimeve shoqërore, detyrimet tatimore, shpenzimeve të drejtpërdrejta të aktivitetit të shoqërisë, lidhur me aktivitete të parashikuara nga buxheti i miratuar.
- j. të bëjnë pagesat që i detyrohet subjektit ndërtues dhe nënkontraktorëve, konform situacionit të punimeve të paraqitur e të miratuar nga eksperti kontabël.
- k. të nënshkruajnë kontratat e sipërmarrjes, të bashkëpunimit apo paraprake të shitjes për objektet që janë në ndërtim e sipër, sipas çmimeve paraprake të miratuara nga ortakët për çdo komponent të ndërtimit të ri.

24.2 Përveç detyrave të treguara më lart për çdo veprim tjetër administratori/ët duhet të marrë më parë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

24.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

24.4 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me votimin unanim.

Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Shpërblimi i administratorëve

25.1 Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

25.2 Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

25.3 Administrator i Shoqërisë "DAGE PERDE" SH.P.K, do të jetë **Z.Dardan Kastrati** me te drejta te plota.

NENI 26 Ekspertët Kontabël

26.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit finansiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme. Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar. Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

VI. MARRËDHËNIET E PUNËS

NENI 27

27.1 Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës. Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.


NENI 28

28.1 Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

VII. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI

NENI 29

29.1 Kjo Shoqëri do të prishet në rast se:



- a. me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - b. me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - c. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrime biznesit", i ndryshuar;
 - d. me vendim të gjykatës;
 - e. për arsyet e tjera, të parashikuara në statut;
- Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratorët.

NENI 30.

Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës

30.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohej ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

30.2 E drejta e tërheqjes i përket:

- ortakëve që nuk kanë aprovuar ndryshimin e objektit apo të llojit të shoqërisë, shkrirjes ose shkëputjes, transferimit të selisë jashtë shtetit, tërheqjes së gjendjes së likuidimit, eliminimit të një ose disa kushteve të tërheqjes të parashikuara nga ky statut, futjes ose heqjes së limiteve në qarkullimin e kuotave;
- ortakëve që nuk kanë lejuar kryerjen e disa veprimeve që nevojiten për një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë apo një ndryshim thelbësor të të drejtave të njoitura ndaj ortakëve;
- në të gjitha rastet e parashikuara nga ligji apo nga ky statut.

30.3 Qëllimi i ortakut që të tërhiqet nga shoqëria duhet t'i komunikohet organit administrues nëpërmjet një letre rekomande me njoftim marrje.

NENI 31

Përashtimi i ortakut

31.1 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:

- a. me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b. me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c. përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
- d. me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

31.2 Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

NENI 32. Likuidimi i shoqërisë

32.1 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

32.2 Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsyet e mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit. Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

32.3 Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata registrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndiqet nga shënim "në

likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 33 **Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

33.1 Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 34 **Bilancet**

34.1 Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 35 **Shpërndarja e aktiveve**

35.1 Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.


Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve.

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

NENI 36 **Likuidimi i thjeshtëzuar**

36.1 Shoqëria tregtare mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, njofojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.



Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 37

37.1 Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 38


38.1 Gjithçka nuk është parashikuar shprehimi i këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 39

39.1 Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKU I VETEM

Z.Dardan Kastrati



Tirane, me 19/10/2020